

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ishte dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Reçit
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/kronike/ishte-denuar-per-n-e-bashkeshortes-49-vjecari-i-jep-fund-i1185915
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:58:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:52:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	edc589c7caabec611b8b6c9f03cf7fef2481e077d4d2a05054ae5afcfe88ec22
TEKSTI	958ad50e6be1140abb91b115c028c86f61cf1c3d28cf90bd6fa2f2d453709b14
PAMJA	72b17212eb8de175d3a7a58bc475dee4bddaa4329f90ac8ac5a042cab5660cd2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b13c8568bc329ccdbff577ac3bad5b77d9dc50a9e272c9f7d22d36ac0e8a84b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b13c8568bc329ccdbff577ac3bad5b77d9dc50a9e272c9f7d22d36ac0e8a84b7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ishte dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Reçit

Nga Senad Nikshiqi
26 Shtator 2026, 17:52 | Kronikë



Një i burgosur në burgun e Reçit i ka dhënë fund jetës. Shtetasi Agron Llapushi, 49 vjeç është gjetur i varur me litar në mjediset e dusheve në burgun e Reçit.

49-vjeçari nuk ka folur me askënd lidhur me këtë veprim duke zgjedhur që t'i japë fund jetës. Agron Llapushi i lindur në fshatin Holtas dhe banues në Çekin të Gramshit, në vitin 2015 vrau bashkëshorten e tij Alketa Llapushi.

Sapo u kthye nga emigrimi në Greqi, asokohe 39 vjeç Llapushi në një arë në Gramsh mbyti bashkëshorten me duar dhe litar duke e lënë të vdekur në vend.

Çifti në fjalë janë prindër të dy fëmijëve që sot janë 20 dhe 19 vjeç ndërsa asokohe ishin ende të vegjël.

Agron Llapushi nuk kishte takime me familjar apo të afërm. Ka patur vetëm një takim në vitin 2023, 8 vite pasi është dënuar dhe një tjetër në vitin 2025. Gjatë gjithë periudhës tjetër, askush nuk e ka takuar 49-vjeçarin.

Pas ngjarjes së rëndë, Agron Llapushi u dorëzua në polici dhe pranoi krimin e rëndë të kryer.

Prokuroria për Krime të Rënda asokohe kërkoi burg përjetë për shtetasin Agron Llapushi por Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e dënoi me 24 vite e 4 muaj burgim për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal. Vendimi mori formë të prerë me datë 10.12.2015 ndërsa ishte arrestuar 8 muaj më parë, me datë 01.04.2015.

Brëfimi i të dënuarit Agron Llapushi pas ngjarjes

Vetë i dënuari që i dha fund jetës, pranoi krimin dhe theksoi se ngjarja erdhi si pasojë e debateve për gjendjen e vështirë ekonomike.

"Jam martuar me Alketa Llapushin që nga viti 2001 dhe kemi dy fëmijë të moshës 10 dhe 9 vjeç.

Në lidhje me ngjarjen dua të deklaroj se kam vite që punoj si emigrant në Greqi në qytetin e Verias.

Para një viti unë kam pasur çrregullime mendore dhe kam kaluar në depresion, ku në disa raste me ka vajtur mendja të vrisja veten. Po kështu para një viti kam bërë një vizitë tek një psikolog në Elbasan me emrin Enrik.

Unë kam 4 ditë që kam ardhur nga Greqia dhe në fshatin ku unë banoj në Çekin jam në

TE FUNDIT

Trump do të bombardojë Iranin pas zgjedhjeve të mesmandatit, media amerikane zbulon detajet

Plani 7-ditor për t'i dhënë fund luftës, zbulohet përgjigja e Trump për propozimin e Iranit

Shpërthen në flakë autobusi në hyrje të tunelit të Elbasanit, bllokohet rruga

Zjarr në një hotel në Gjirokastrë, forcat zjarrfikëse në terren

MË TË VIZITUARAT

Gërvalla mohon bashkëpunimin me Specialen: Nuk kam pasur asnjë pikëtakim

Wendt në Tiranë, ambasada amerikane pas takimit me Begajn: Diskutuan për çuar...

Aksident në aksin Gjirokastrë-Kakavijë, 77-vjeçarja përfundon në spital

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

kushte të vështira ekonomike, ku unë jetoj bashkë me nusen time dhe dy fëmijët në një dhomë të vetme.

Sot unë kam shkuar në mëngjes për të punuar në një tokë larg shtëpisë në vendin e quajtur "Mhalla e Lepurit " dhe atje në punë e sipër jam konfliktuar me Alketën, dhe gjatë konfliktit unë e kam shtrënguar me duar në fyt derisa ajo ka humbur ndjenjat.

Pas kësaj kam shkuar në shtëpi dhe kam lajmëruar me telefon vëllain tim Alfredin dhe me pas kam shkuar dhe jam dorëzuar në polici. Marrëdhëniet në përgjithësi me Alketën, i kam pasur të mira nuk kemi pasur probleme. As vetë nuk e di si ndodhi... “

Ekspertiza psikiatrike

Për të provuar se Agron Llapushi ishte mirë mendërisht në momentin kur mbyti gruan me duar dhe më pas i shtrëngoi litarin në qafë, prokuroria urdhëroi që ti kryhej një ekspertizë psikiatrike. Konkretisht, akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor nr.194 datë 16.06.2015 mbi ekzaminimin e shtetasit Agron Llapushi.

Mjekët psikiatër i janë përgjigjur pyetjeve nëse i pandehuri vuan nga ndonjë turbullim psikik apo neuropsikik në kohën e kryerjes së veprës penale dhe nëse ai vuan, a ka ndikuar kjo në prishjen e ekuilibrit të tij mendor duke e bërë atë të papërgjegjshëm para ligjit?

Ato kanë arritur në konkluzionin se ai nuk vuan nga ndonjë sëmundje (turbullim) psikike a neuropsike.

Simptomat për të cilat ai pretendon se është kuruar nuk plotësojnë kriteret diagnostike për sëmundje madhore mendore. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Durrës, 28-vjeçari filipinez humb jetën teksa punonte në varkë



Operacion në Shkodër e Tiranë, Endrit Dokle në kërkim, kapet Bledar Cafi



Zbardhet plagosja me armë në Tiranë, shpallet në kërkim autori dhe arrestohet i plagosuri

I dënuar me 6 vite burg, arrestohet 41-vjeçari në Fushë-Krujë

Vodhi makinën në Tepelenë dhe përplasi katër automjete, arrestohet 30-vjeçari në Durrës

SPAK operacion në Shkodër dhe Tiranë, arrestohet Bledar Cafi! Indrit Dokle i shpëton policisë

Latest Videos



"Kurti gati por Ngërçi tek Rama? Shqipëria hap fals.. Kë takoi Kurti në SHBA? Gërvalla gati në lot?"



A po lobon Kosova e Kurti për një takim me Trump në Shtëpinë e Bardhë? Zaimi: S'ka çështje që...



"Kë takoi Kurti në Amerikë? Mbeti kafeneve dhe byrektoreve?" Flet anëtari i Kryesisë së LVV



"Kosova e ka njoftuar Shqipërinë për Vlora Hysenin. Shpresoj që sekreti shtetëror për Kosovën të mos

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulohet
Imagjinatë
Dëshmi



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.